

MARSELA BEBRI

**DREJTSHKRIMI I BASHKËTINGËLLOREVE NISTORE
SH-, ZH-, Ç-, S-, Z- NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT / TË LARTË**

Hyrje

Shkrimi i bashkëtingëlloreve nistore *sh-*, *zh-*, *ç-*, *s-*, *z-* është një ndër çështjet e rëndësishme drejtshkrimore të trajtuara si në Projekt edhe në Kongresin e Drejtshkrimit, ku rregullat e këtij të fundit respektohen edhe në ditët e sotme në të gjitha fushat e veprimtarisë sonë. Kjo çështje është trajtuar nga studiues të ndryshëm, si: N. Bardhi, H. Qosja, E. Çabej–A. Xhuvani, N. Cikuli, E. Hysa, Xh. Gosturani, J. Thomai, të cilët i kanë trajtuar si bashkëtingëllore nistore, por edhe si parashtesa me apo pa funksion të përcaktuar.

N. Cikuli¹ trajton problemet e drejtshkrimit të bashkëtingëlloreve nistore *sh-/ç-*. Sipas saj, deri në vitin 1960 para bashkëtingëlloreve të pazëshme (*f*, *p*, *q*, *t*, *th*, *h*) dhe para bashkëtingëlloreve të zëshme (*b*, *d*, *g*, *gj*, *v*) është përdorur përgjithësisht *ç-*ja, p.sh.: *çfrytëzim*, *çkathtësi*, *u çpall*, *u çduk*, *çvillim* etj., kurse *sh-*ja del vetëm në raste sporadike. Pas viteve 1960, sidomos pas vitit 1962, gjendja ndryshon, kalohet nga *ç-* në *sh-* dhe *zh-* (*shfrytëzim*, *shkatërrim*; *shpifje*, *zhdukje*, *zhvillim* etj.). Më përpara *sh-*ja dhe *zh-*ja nistore filluan të përdoreshin në shtyp e më pas në letërsinë artistike, kurse *ç-*ja parashtesë ose jo, po rezistonte më tepër para bashkëtingëllores së pazëshme *p* dhe më pak para bashkëtingëllores së zëshme *d*.

A. Xhuvani–E. Çabej² bashkëtingëlloret *sh-*, *zh-*, *ç-*, *s-*, *z-* i kanë trajtuar edhe si bashkëtingëllore nistore, edhe si parashtesa me ose pa funksion, shpesh herë me variante dialektore.

H. Qosja³ parashtron disa argumente në të mirë të njërit apo tjetrit formant. Sipas tij, jepet pa kriter përjashtimi në rregullin mbi shkrimin e fjalëve me *zh-* apo me *ç-*, kur udhëzohet që para bashkëtingëlloreve të zëshme *d*, *g*, *v*, *sh-*ja ose *ç-*ja të kthehen në *zh-*, p.sh.: *i zhdrejtë*, *zhvilloj* etj. dhe po aty thuhet se shkruhen me *ç-* fjalët *çbëj*, *çvendos*, *çvidhos*, *çvleftësoj*, *çvulos*, megjithëse shihet qartë se parashtesa ndodhet në të njëjtat kushte fonetike në të dyja rastet. Përkrah rregullat e Projektit të vitit 1967 për disa arsye. Si fillim, ai vlerëson parimin fonetik që është ndjekur, i cili është një parim i formuluar në pajtim me shqiptimin më të

¹ N. Cikuli, *Zhvillimi i drejtshkrimit të shqipes pas çlirimit*, në: “Studime filologjike”, Tiranë, 1970/4. f. 56.

² A. Xhuvani–E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, “Studime gjuhësore III”, Rilindja, Prishtinë, 1976, f. 153-154, 176-177, 179-180, 184-186.

³ H. Qosja, *Mbi drejtshkrimin e fjalëve me sh-/ç-/zh- nistore*, në: Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20–25 nëntor 1972, Prishtinë, 1972, f. 306.

përgjithshëm dhe vendosjen e rregullave të prera pa përjashtime.⁴ Për sa i përket rolit morfologjik, *sh*-ja ka një përdorim më të gjerë se *ç*-ja, kështu pajtohet me mendimin e Xhuvanit dhe Çabejt se përdorimi morfologjik i *sh*-së është shumë më i gjerë sesa i *ç*-së, duke përfshirë edhe emrat. Si rrjedhim, edhe formimet e reja mbizotërojnë me *sh*-. Ka dukuri në gjuhë që nuk lidhen me veprimin e normave fonetike të sotme, por me bashkëveprimin e dialekteve në procesin e formimit të gjuhës letrare, p.sh.: *sh*-ja në fjalë si *shmang*, *shlyej* etj., *çliroj* etj., ose përdorimi i *sh*-së para grupeve të bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*.

N. Bardhi thekson se *s*-ja nistore, parashtesë ose jo, duhet të shkruhet *s*- dhe (jo *c*-) para një bashkëtingëlloreje të shurdhët dhe *z*- (e jo *s*-, *c*- ose *x*-) përpara një bashkëtingëlloreje të zëshme. Shqiptimi i fjalëve me *c*-, *s*-, *x*- është tepër i ngushtë, dialektor dhe arkaik. Fjalët *zbres*, *zdrukth*, *zgjoj*, *zgjyrë* të shkruhen me *z*- dhe jo me *c*-, *s*-, *x*-, kurse fjalët *skuq*, *sfungjer* etj. të shkruhen me *s*- dhe jo me *c*-. Që rregulli të jetë më i qartë, sipas tij, duhen ndarë më vete rastet kur kemi parashtesë nga rastet kur kemi *s*-/*z*- nistore. Parashtesa *z*-është mjaft prodhuese në gjuhën shqipe për formimin e foljeve nga mbiemrat, p.sh.: *zbardh*, *zgjat*, *zbus*, *zmadhoj*, *zbukuroj* etj. dhe për krijimin e antonimeve, p.sh.: *zbath*, *zbërthej*, *zbaticë*, *zbuloj* etj.

Për studiuesin Bardhi, fjalët e tipit *cfilit*, *sfurk*, *cfrat*, *cmirë*, ku tingulli nistor nuk është parashtesë ose kur funksioni i parashtesës nuk është i qartë, duhet të shkruhen me *c*- dhe jo me *s*-. Për të mbështetur këtë mendim është parë shqiptimi i tyre i përgjithshëm dhe tradita e shkrimit. Gjatë praktikës shkollore vuri re se këto fjalë shkruheshin më shumë me *c*- sesa me *s*-, madje edhe “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954) si trajta të para jep fjalët me *c*-: *cfilit*, *sfurk*, *cfrat*, *cmirë*. Përsa i përket rasteve të fjalëve si *cmirë* apo *cmilar*, sipas tij, nuk duhet të shkruhen me *s*-, edhe pse bashkëtingëlloret *m* ndiqet nga një *i*. Shkrimi i tyre me *s*- përbën një njësim formal, mbasi e shikon punën nga pikëpamja historike-etimologjike.

Problem më vete paraqesin edhe fjalët e huaja me *s*- nistore, si *smoking*, *slogan* etj. Ato shqiptohen me *s*- për shkak se nuk janë përvetësuar fonetikisht nga gjuha shqipe dhe ndikon gjuha nga vijnë.

Tek studiuesi **E. Hysa**⁵ do të shohim se bashkëtingëlloret nistore *sh*-, *zh*-, *ç*-, *s*-, *z*- janë trajtuar vetëm si parashtesa (p.sh.: *çmontoj*, *çarmatos*, *i çrregullt*, *spastroj*, *skuq*, *sforcoj*, *shthur*, *shqetësoj*, *shpopulloj*, *shpërngul*, *zvarris*, *zbardh*, *zhvesh*, *zhduk*, *zhbiroj* etj.); a) me funksion antonimik, të cilat janë formime të vjetra p.sh.: në gjuhën shqipe ekzistojnë çiftet: *mbuloj*/*zbuloj*, *mbath*/*zbath*, *ngul*/*shkul*, *ngarkoj*/*shkarkoj*, *ngjis*/*shqis*, *mbërthej*/*zbërthej* etj.;⁶ b) parashtesa me bashkim me prapashtesim zero (formime parashteso-prapashtesore), p.sh.:

⁴Po ai, *po aty*, f. 308.

⁵E. Hysa, *Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe*, në: “Studime filologjike”, 1973/3, f. 91.

⁶Po ai, *po aty*, f. 98.

Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve nistore **sh-, zh-, ç-, s-, z-** në arsimin...

zbukuroj (z-bukur-o-j), shfletoj, shpronësoj, shfrytëzoj, zhdoganoj, zhgjakësoj, zgjeroj etj.; c) parashtesë + prapashtesim zero, si: zbardh, zverdh, zbyth, skuq.⁷

Në rolin e parashtesave i trajton bashkëtingëlloret nistore edhe studiuesi **Xh. Gosturani**⁸, ashtu si E. Çabej, të cilat i ndan me disa funksione. Parashtesa *sh-*, e cila paraqitet me variantet *ç-, xh-, zh-*, u parangjitet foljeve duke dhënë:

- a) kuptim intensiv ose faktitiv: *zhbiroj, zhdredh, shndrit, shliroj*;
- b) kuptim antonimik: *shbâj, çbâj, shkul, shlyej, shthur, zhburrnoj, zhvesh, çvesh*.
- c) kuptim të ndarjes, shpërndarjes: *shprish, shdredh, shkoq*;

Përhapja dhe zbatimi i një drejtshkrimi të njësuar në të gjitha sferat e veprimit të fjalës së shkruar ka ndihmuar në përvetësimin e ngulitjen e normave të gjuhës letrare.⁹

Materiali dhe metoda

Për realizimin e këtij studimi janë testuar **210** nxënës, nga klasa VI–XII (një klasë për secilën). Periudha e studimit është 18.12.2014–06.02.2015, përkatësisht:

- Klasa **VI–D**, shkolla “Gjon Buzuku”, **36** nxënës, më 18.12.2014;
- Klasa **VII–B**, shkolla “1 Maji”, **36** nxënës, më 19.12.2014;
- Klasa **VIII–B**, shkolla “Gjon Buzuku”, **29** nxënës, më 18.12.2014;
- Klasa **IX–D**, shkolla “1 Maji”, **29** nxënës, më 19.12.2014;
- Klasa **X–16**, gjimnazi “Ismail Qemali”, **23** nxënës, më 6.2.2015;
- Klasa **XI–3**, gjimnazi “Sami Frashëri”, **32** nxënës, më 4.2.2015;
- Klasa **XII–15**, gjimnazi “Ismail Qemali”, **25** nxënës, më 5.2.2015.

Të dhënat e nxjerra prej testit janë analizuar dhe interpretuar, duke i shoqëruar me tabela dhe grafikë. Metodën e përdorur janë *metoda e hulumtimit dhe e grumbullimit, metoda statistikore dhe krahasuese, metoda analitike*.

Gjatë studimit janë marrë parasysh *klasa, origjina dhe gjinia* e nxënësve në përdorimin e fjalëve që fillojnë me bashkëtingëlloret nistore *sh-, zh-, ç-, s-, z-* dhe ndërtimi i fjalëve të prejardhura me anë të tyre në rolin e parashtesave. Është bërë një krahasim i të dhënave (gabimeve) mes nxënësve nga *veriu dhe jugu, djemve dhe vajzave*, i 10 fjalëve të shkruara më shumë gabim për secilën klasë dhe i 10 fjalëve të prejardhura të ndërtuara më shumë gabim.

Rezultatet

Për të parë drejtshkrimin e bashkëtingëlloreve nistore *sh-, zh-, ç-, s-, z-* nga nxënësit shohim të dhënat e mëposhtme:

Tabela 1. *Fjalët me përqindjen më të madhe të gabimeve në test, klasat VI–XII. (Burimi: Realizuar nga autori).*

⁷ Po ai, *po aty*, f. 99-100.

⁸ Xh. Gosturani, *Vëzhgime për formimin e fjalëve në gegërishten verilindore*, në: “Studime filologjike”, 1992/1-4, f. 117.

⁹ Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, *Rezolutë e Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe*, “Studime filologjike”, 1973/1, f. 32.

MARSELA BEBRI

FJALËT ME PËRQINDJEN MË TË MADHE TË GABIMEVE NË TEST, SIPAS KLASAVE							
N r .	Klasa VI-D 36 nxënës	Klasa VII-B 36 nxënës	Klasa VIII-B 29 nxënës	Klasa IX-D 29 nxënës	Klasa X-16 23 nxënës	Klasa XI-3 32 nxënës	Klasa XII- 15 25 nxënës
1	Çlodh/je 59%	Zhvleftësim 78%	Zhdoganoj 86%	Zhbërë 76%	Çlodh/je 70%	Çlodh/je 59%	Çlodh/je 76%
2	Zhblllokoj 38%	Zhdoganoj 75%	Zmbraps 76%	Zhdoganoj 66%	Sththur/je 52%	Zhblllokoj 38%	Zhbërë 60%
3	Zhdoganoj 34%	Sththur 69%	Çlodh 59%	Smalt 66%	Smalt 48%	Zhdoganoj 34%	Zhvleftësim 48%
4	Spërndrit 31%	Zhbërë 53%	Shfajësoj 55%	Sththur/je 52%	Zhdoganoj 48%	Spërndrit 31%	Sththur/je 48%
5	Sththur/je 31%	Smalt 53%	Sththur/je 52%	Çlodh/je 52%	Spërndrit 44%	Sththur/je 31%	Smalt 44%
6	Smalt 31%	Smerald 33%	Smerald 52%	Zhvleftësim 48%	Zgërdhiheshin 39%	Smalt 31%	Zhblllokoj 44%
7	Shkujdesem 31%	Spërndrit 33%	Zhbërë 48%	Spërndrit 45%	Zhbërë 35%	Shkujdesem 31%	Shpyllëzuar 40%
8	Zhvleftësim 28%	Shpërfytyroj 25%	Zhblllokoj 48%	Çrrënjës 45%	Zmbraps 30%	Zhvleftësim 28%	Zhvendos 40%
9	Zmbraps 19%	Shpyllëzuar 25%	Zhvendos 45%	Zhvendos 45%	Zhvleftësim 26%	Zmbraps 19%	Shqeppte 40%
10	Smirë 19%	Çlodh/je 25%	Zhvleftësim 41%	Shkujdesem 41%	Çrrënjës Zhvendos 26%	Smirë 19%	Zmbraps 40%

Tabela 1 paraqet 10 fjalët me përqindjen më të madhe të gabimeve për secilën klasë. Për nxjerrjen e përqindjes së gabimeve është marrë parasysh numri i fjalëve të testit (**70 fjalë**), numri i fjalëve të shkruara gabim nga të gjithë nxënësit.

Fjalët, që kanë numrin më të madh të gabimeve nga klasa VI–XII, janë: *çlodh/je*, *zhdoganoj*, *sththur/je*, *zhvleftësim*, *smalt*, *spërndrit*, *zhbërë*, *smerald*, *smirë*, *zhblllokoj*, *çrrënjës*, *zmbraps*, *shfajësoj*, *shkujdesem*, *shpyllëzuar*, *zhvendos*, *zgërdhiheshin*, *shqeppte*. Variantet e gabuara me të cilat dalin kryesisht këto fjalë janë: *shlodh/je*, *çdoganoj*, *çthur/je*, *çvleftësim*, *zmalt*, *zmerald*, *shpërndrit*, *çbërë*, *cmirë*, *çblllokoj*, *shrrënjës*, *smbrops*, *çfajësoj*, *çkujdesem*, *çpyllëzuar*, *çvendos*, *sgërdhiheshin*, *çqeppte*, por më pak janë: *shdoganoj*, *shvleftësim*, *shbërë*, *smerald*, *shblllokoj*, *xhvendos*. Shohim që dominojnë variantet me **ç**- në vend të **sh**-së dhe të

Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve nistore **sh-**, **zh-**, **ç-**, **s-**, **z-** në arsimin...

zh-së, variantet me **sh**- në vend të fjalëve që fillojnë me **ç**-; variantet me **z**-në vend të **s**-së, si dhe **xh**-ja në vend të **zh**-së.

Fjalët që kanë përqindjen më të lartë në të gjitha klasat nga kjo dhjetëshe janë: *çlodh/je*, *zhdoganoj*, *shthur/je*, *zhvleftësim*, *smalt*, me një renditje mesatare fjalët: *zhbërë*, *spërndrit*, *zhbllokoj*, *smerald*, *shpyllëzuar*, *zhvendos*, *shfajësoj*, kurse me përqindje më të ulët janë fjalët: *zmbrops*, *shqeppte*, *shkujdesem*, *çrrënjës*, *shpërfytyroj*, *smirë*.

Fjalët që dalin vetëm një herë, në një klasë, janë: *shfajësoj* (VIII-B), *shqeppte* (XII-15), *zgërdhiheshin* (X-16), *shpërfytyroj* (VII-B); dy herë: *smirë* (VI-D, XI-3), *shpyllëzuar* (VII-B, XII-15), *çrrënjës* (IX-D, X-16); tri herë janë fjalët: *zhvendos* (VIII-B, IX-D, XII-15), *shkujdesem* (VI-D, IX-D, XI-3). Fjala *zmbrops* nuk del në klasat VII-B dhe IX-D.

Tabela 2. Fjalët e prejardhura të krijuara me anë të parashtesave *sh-*, *zh-*, *ç-*, *s-*, *z-* me përqindjen më të madhe të gabimeve, klasa VI–XII. (Burimi: Realizuar nga autori).

FJALËT E PREJARDHURA ME PËRQINDJEN MË TË MADHE TË GABIMEVE SIPAS KLASAVE							
Nr .	Klasa VI-D 36 nxënës	Klasa VII-B 36 nxënës	Klasa VIII-B 29 nxënës	Klasa IX-D 29 nxënës	Klasa X-16 23 nxënës	Klasa XI-3 32 nxënës	Klasa XII-15 25 nxënës
1	Shkombëtar izoj 92%	Zhdoganoj 86%	Shkombëtar izoj 89%	Zhdoganoj 63%	Zhdoganoj 47%	Çmbështjell 43%	Shkombëtarizoj 37%
2	Shndrit 92%	Zhdëmtoj 75%	Zhdoganoj 86%	Shkombëtarizoj 53%	Shkombëtarizoj 33%	Zhdoganoj 33%	Zhdëmtoj 37%
3	Shpronësoj 88%	Shkombëtar izoj 72%	Zverdh 86%	Zhdëmtoj 43%	Çndotje 30%	Shkombëtarizoj 33%	Zhdoganoj 30%
4	Zhdoganoj 83%	Shpengoj 50%	Zhvlerësoj 79%	Çndotje 33%	Zhdëmtoj 27%	Zhdëmtoj 30%	Shpronësoj 23%
5	I zverdhur 75%	Zhvlerësoj 42%	I zmadhuar 79%	Shpengoj 30%	Shpronësoj 23%	Çndotje 20%	Shpengoj 23%
6	Zhdëmtoj 72%	Çmbështjell 36%	Shpalos 69%	Çngjyros 27%	I zmadhuar 20%	Shpengoj 20%	Çmbështjell 23%
7	Shpengoj 69%	Shpronësoj 28%	Shpengoj 66%	Zhvlerësoj 23%	Shpengoj 17%	Shpronësoj 17%	Zhvlerësoj 20%
8	Çmbështjell 67%	Çngjyros 28%	Çmbështjell 62%	I zmadhuar 23%	Zhvlerësoj 13%	I zmadhuar 17%	Shndrit 10%
9	Çngjyros 56%	Çnderoj 17%	Shfaq 62%	Çntegrim 23%	Çmbështjell 13%	Shndrit 10%	Çndotje 10%
10	Çrrënjës 50%	Shndrit 14%	Çngjyros 59%	Çrrënjës 20%	Çnderoj 13%	Çminoj 10%	Çnderoj 10%

Tabela 2 paraqet 10 fjalët e prejardhura me përqindjen më të madhe të gabimeve për secilën klasë. Për nxjerrjen e përqindjes së gabimeve është marrë parasysh numri i fjalëve (temave) që janë dhënë në test për të krijuar me to fjalë të prejardhura (**30 gjithsej**), numri i fjalëve të shkruara gabim nga të gjithë nxënësit dhe numri i nxënësve, pasi shohim që klasat kanë numër të ndryshëm nxënësish dhe ky fakt ka mjaft ndikim.


Fjalët, që kanë numrin më të madh të gabimeve nga klasa VI–XII, janë: **shkombëtarizoj, zhdoganoj, zhdëmtoj, shpengoj, shpronësoj, çmbështjell, zhvlerësoj, çngjyros, çnderoj, çndotje, çrrënjës, shndrit, shfaq, i zmadhuar, zverdh, çminoj**. Variantet e gabuara me të cilat dalin kryesisht këto fjalë janë: **shkombëtarizoj, çdoganoj, çdëmtoj, çpengoj, çpronësoj, shmbështjell, çvlerësoj, shngjyros, shnderoj, shndotje, shrrënjës, çndrit, çfaq, i smadhuar, sverdh, shminoj**, por më pak janë: **shdoganoj, shdëmtoj, shpengoj, smbështjell, shvlerësoj, zhndrit**.

Shohim që dominojnë variantet me **ç-** në vend të **sh-**së dhe të **zh-**së, variantet me **sh-** në vend të fjalëve që fillojnë me **ç-**, si dhe variantet me **s-** në vend të **z-**së.

Fjalët që kanë përqindjen më të lartë në të gjitha klasat nga kjo dhjetëshe janë: **shkombëtarizoj, zhdoganoj, zhdëmtoj**, me një renditje mesatare fjalët: **i zmadhuar, zverdh, shpengoj, çmbështjell**, kurse me përqindje më të ulët janë fjalët: **çrrënjës, çnderoj, çngjyros**.

Fjala **çmbështjell** është e pranishme në të gjitha klasat, me përjashtim klasën IX-D. Del në vend të parë vetëm në klasën XI-3 (me 43%). Fjala **çminoj** del në këtë dhjetëshe vetëm në klasën XI-3, kurse fjala **shpalos** vetëm në klasën VIII-B.

Grafiku 1



Grafiku 1 përmbledh përqindjet e gabimeve të nxënësve (në test) nga klasa VI–XII, sipas ndarjes veri–jug, sipas origjinës së tyre. Duke iu referuar këtij grafiku, por edhe tabelave të të dhënave të gabimeve (të nxënësve të veriut ose të jugut) për çdo klasë, sipas të cilave numri i nxënësve të jugut në të gjitha klasat është dyfish më i madh. Vëmë re që gabimet në përdorimin e fjalëve që fillojnë me


Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve nistore **sh-, zh-, ç-, s-, z-** në arsimin...

bashkëtingëlloret nistore **sh-, zh-, ç-, s-, z-** janë **më të shumta te nxënësit nga jugu i Shqipërisë.**

Mendojmë se kemi këtë rezultat si pasojë e **ndikimit të fortë që ka origjina**, elementi dialektor ose krahinor në gjuhë. Në mbështetje të këtij mendimi vijnë edhe rezultatet e **ushtrimit nr. 7 të testit**, ku pothuajse të gjithë nxënësit, me përjashtim të disave të klasës VII-B, nuk ishin në gjendje të shpjegonin pse fjalët e dhëna ishin shkruar gabim.¹⁰

Te nxënësit e jugut kryesisht, dhe më pak tek ata të veriut, dominojnë variantet me **ç-** në vend të **sh-së** dhe të **zh-së**. Tek të dyja grupet kemi variantet me **sh-** në vend të fjalëve që fillojnë me **ç-**; variantet me **z-** në vend të **s-së**, si dhe **xh-**ja në vend të **zh-së**.

Grafiku 2



Grafiku 2 është grafiku më përmbledhës i rezultateve të nxjerra nga përdorimi i bashkëtingëlloreve nistore **sh-, zh-, ç-, s-, z-** nga nxënësit e klasave VI–XII. Shohim që përqindja e gabimeve është i lartë te testi (përdorimi i fjalëve të shkëputura), por dhe tek formimi i fjalëve të prejardhura, ku bashkëtingëlloret nistore luajnë funksionin e parashtesave. Gjykojmë që ky rezultat vjen si pasojë e:

- *fondit të gjerë të fjalëve* që fillojnë me këto bashkëtingëllore nistore (shumë raste për secilën, përfshirë këtu edhe përjashtimet, larmishmëri shembujsh). Testi u ndërtua në atë mënyrë që fjalët të ishin të përziera, të vendosura në disa lloje

¹⁰ Shpjegimi lidhet me rregullat drejtshkrimore për secilën bashkëtingëllore nistore, pra me pozicionin fonetik, d.m.th. kanë ndjekur atë formë fjalësh që e kanë dëgjuar më shpesh.

ushtrimesh. Ky fond fjalësh i bëri nxënësit pak konfuzë, i vuri në mëdyshje për shumë raste;

- mosmbajtjes mend e rregullave drejtshkimore për përdorimin e këtyre bashkëtingëlloreve;

- vështirësive, paqartësisë që kishin nxënësit rreth fjalëve të prejardhura;

- përgjithësisht, klasat VII-B dhe klasa XI-3 e kanë përqindjen më të ulët të gabimeve, kurse klasa IX-D më të lartë, pasi edhe gabimet ishin më të shumta. Te klasa VII-B mund të ndikojë fakti që drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve nistore *sh-*, *zh-*, *ç-*, *s-*, *z-* ishte trajtuar te kjo klasë disa orë para se të testoheshin nga ana jonë dhe normalisht njohuritë i kishin më të freskëta;

- më tepër gabimet janë bërë nga vajzat, me përjashtim klasën IX-D, ku dominojnë djemtë.

Përfundime

Fjalët që fillojnë me bashkëtingëlloren *sh-* dhe që dalin gjatë përdorimit me *ç-*, përgjithësisht janë përdorur në këtë formë nga nxënësit me origjinë nga jugu i Shqipërisë, kryesisht nga zona e Korçës dhe më tepër nga vajzat.

Bashkëtingëllorja nistore *ç-* del shumë shpesh në vend të *sh-së* dhe *zh-së*, si pasojë e ndikimit dialektor apo krahinor nga vijnë nxënësit, si p.sh.: *shfaq*, *çfaq*; apo zhvesh, *çvesh*. Kemi parasysh edhe faktin që në krahasim me *sh-në* *ç-*ja ka një vlerë afektive, ekspresive ose emocionale në gjuhë.¹¹

Duke u nisur nga gabimet e shumta të nxënësve, kryesisht në test (ku edhe numri i fjalëve të përzgjedhura është rreth 70), duke iu referuar ushtrimit të fundit të tij, që kërkon prej nxënësve të shpjegojnë *pse fjalët janë shkruar gabim, cilat janë rregullat që duhen ndjekur*, si dhe faktit që pothuajse të gjithë nxënësit nuk e kishin zgjidhur atë, me përjashtim të disa nxënësve të klasës VII, kemi arritur në përfundimin se nxënësit e klasës VI, VIII, IX, X, XI dhe XII kanë ndjekur parimin fonetik, d.m.th. ashtu siç i kanë dëgjuar më shpesh dhe jo kushtëzimin fonetik (rregullat drejtshkimore).

Parashtesa *zh-* alternohet shpesh me *xh-në* (*xhvendos*, *xhvat*), me *ç-në* (*çdoganoj*), por edhe me *sh-në* (*shvendos*, *shvlerësoj* etj).

Nxënësit ngatërrojnë mjaft edhe *z-në* me *s-në*, si p.sh.: *sverdhur*, *sqjati*, *sbërthyer*, apo e kundërta si në fjalët: *zmalt* e jo *smalt*, *zmerald* e jo *smerald* etj.

Mjaft gabime kemi konstatuar nga nxënësit edhe në krijimin e fjalëve të prejardhura me anë të bashkëtingëlloreve nistore *sh-*, *zh-*, *ç-*, *s-*, *z-*, në funksionin e parashtesave, ku një ndikim të fortë kishin edhe paqartësi të rreth fjalëve të prejardhura. Gjatë formimit të këtyre fjalëve temat me të cilat nuk është bërë asnjë gabim ose shumë pak të tilla janë: *armatos*, *këput*, *integrim*, *njerëzor*, *orientim*, *rregulloj*, *i drejtë*, *palos*, *regjistroj*, *i kuq*, kurse te fjalët e prejardhura nga temat: *kombëtarizoj*, *doganoj*, *pronë*, *dëmtoj*, *pengoj*, *mbështjell* gabimet janë të shumta.

Në secilën klasë të marrë në studim gabimet më të shumta i shohim te nxënësit nga jugu, kryesisht te vajzat, ku edhe numri i tyre ishte më i madh.

¹¹ Shih: A. Xhuvani – E. Çabej, *vep. cit.*

Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve nistore **sh-, zh-, ç-, s-, z-** në arsimin...

Fjalët e shkruara më shumë gabim janë: *çlodh/je, shthur/je, zhvleftësim, smalt, zhdoganoj, spërndrit, zhbërë, zmbraps, shkombëtarizoj, shpengoj, zhdëmtoj, çmbështjell, zhvendos, shpronësoj, çmallem*, të cilat dalin kryesisht në format: *shlodh/je, çthur/je, zmalt; shdoganoj, çdoganoj; shpërndrit; çbërë, zbërë, shbërë; smbraps, çkombëtarizoj, çpengoj; çdëmtoj, shdëmtoj; shmbështjell, smbështjell; shvendos, çvendos, xhvendos; çpronësoj, shmallem* etj.

Fjala *zhvleftësoj* (folje) është shkruar gabim shumë pak nga nxënësit, kurse fjala *zhvleftësim* (emër) është më e gabuara nga të gjithë, edhe pse vijnë nga e njëjta temë (VII-B).

Fjalët *spërndrit, zhvleftësim* përgjithësisht janë shkruar gabim, pasi pothuajse për të gjithë nxënësit ishin jo shumë të dëgjua dhe nuk e kishin shumë të qartë kuptimin e tyre.

Fjalët *slogan, smerald, shndërroj, çndotje, zbaticë* janë quajtur gabim nga nxënësit me këtë formë, kurse fjalët *sfilit* dhe *smirë* dalin gabim vetëm me format *cfilit, cmirë*.

Mësuesit gjatë orës së mësimit, por edhe në veprimtari të tjera mësimore, duhet t'i kushtojnë më shumë rëndësi gabimeve drejtshkrimore të nxënësve, pasi origjina (krahina, dialekti), niveli arsimor dhe kulturor i nxënësve dhe i familjeve të tyre kanë një ndikim shumë të madh në të folurin, në të shprehurin, si dhe në të shkruarën e tyre. Numri i madh i gabimeve në të shkruar kërkon një kontroll sistematik nga ana e mësuesve.

BIBLIOGRAFI

- A. Kostallari, *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, në: "Studime filologjike", Tiranë, 1970/2.
- A. Xhuvani–E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, në: "Studime gjuhësore" III, Rilindja, Prishtinë, 1976.
- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1973.
- E. Hysa, *Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe*, në: "Studime filologjike", Tiranë, 1973/3.
- Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1974.
- Gj. Shkurtaç, *Si të shkruajmë shqip*, Botimet Toena, Tiranë, 2008.
- H. Qosja, *Mbi drejtshkrimin e fjalëve me sh-/ ç-/ zh- nistore*, në: Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20–25 nëntor 1972, Prishtinë, 1972.
- J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2005.
- Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20–25 nëntor 1972*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1972.
- N. Bardhi, *Mbi drejtshkrimin e fjalëve me s- nistore*, në: Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20–25 nëntor 1972, Prishtinë, 1972.
- N. Cikuli, *Zhvillimi i drejtshkrimit të shqipes pas çlirimit*, në: "Studime filologjike", Tiranë, 1970/4.
- R. Memushaj, *Shqipja standarde*, Botimet Toena, Tiranë, 2005.
- R. Petro dhe të tjerë, *Gjuha shqipe 7*, Botimet Albas, Tiranë, 2006–2014.
- Xh. Gosturani, *Vëzhgime për formimin e fjalëve në gegërishten verilindore*, në: "Studime filologjike", Tiranë, 1992/1–4.

